



### Legalizimi i çertifikatave të Republikës së Kosovës

Legalizimi i shërben synimit për pëdorim të çertifikatave kosovare në Gjermani brenda qarkullimit të tyre mes shtetesh. Për të shmangur shpenzimet eventuale të panevojshme, rekomandohet që fillimisht të siguroheni nga institucioni përkatës brenda Gjermanisë, nëse atje kërkohet domosdoshmërisht legalizimi i çertifikatave.

Mund të legalizohen vetëm çertifikatat civile, të cilat iu referohen lindjeve dhe lidhjes së martesave pas datës 18.02.2013 (Lansimi i Regjistrimit Qendror i të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës). Për çertifikata të tjera zyrtare nga Republika e Kosovës nuk ka parakushte për legalizim. Për këtë arsye, me miratim të Ministrisë Federale për Punë të Jashtme këto çertifikata nuk legalizohen. Në raste të domosdoshme mund të bëhet një verifikim i çertifikatave (shih fletëinformacionin e veçantë).

Parakusht për legalizimin përfundimtar të një çertifikate nga ana e ambasadës është vërtetimi paraprak nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës:

Ministria e Punëve të Brendshme  
Agjencia e Regjistrimit Civil  
Rruga: "Luan Haradinaj" p.n.  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Zyra për Komunikim Publik  
Tel: + 381 (0) 38 200 19 545  
E-Mail: zip-mpb@rks-gov.net

Gjuhët e korrespondencës janë: gj. shqipe, serbe dhe angleze.

Çertifikatat origjinale që bartin shënimin e verifikimit paraprak të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës mund të legalizohen në Ambasadën Gjermane në Prishtinë. Nëse duhet të legalizohet një ekstrakt nga Regjistri Qendror i të Dhënave Personale, dokumentit patjetër i duhet bashkangjitur çertifikata e lindjes. Përkthimi në gjuhën gjermane i çertifikatës së synuar të legalizohet nuk është i domosdoshëm.

Çertifikata që synohet të legalizohet duhet të dorëzohet në ambasadë pas caktimit paraprak të terminit nëpërmjet faqes: [www.pristina.diplo.de](http://www.pristina.diplo.de). Kohëzgjatja e përpunimit është së paku tri ditë pune. Tarifa për legalizim është 25 euro për çertifikata personale civile.

Pronari i çertifikatës duhet patjetër të paraqitet personalisht (nëse p.sh. është me qëndrim në Gjermani) Në rast të paraqitjes së çertifikatës nga ana e një personi të autorizuar, ai me këtë rast, përveç autorizimit të nënshkruar nga pronari i çertifikatës, duhet të dorëzojë edhe një fotokopje të pasaportës së udhëtimit, apo të letërnjoftimit të pronarit të çertifikatës.

**Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.**